



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 42
Prishtinë, më 10. 09. 2009, ora 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri – kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujoviq, Nerxhivane Dauti, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Naim Rustemi, Ibrahim Makolli, Danush Ademi, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati.

Mbledhjen e mbikëqyrën: Denny Filiks – OSBE, Elita Vokshi – OSBE, Rrezarta Ahmeti – KDI dhe Nexhat Shatri – Zyra e Presidentit.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinator, zyrtar i lartë dhe Visar Krasniqi - zyrtar ligjor.

Kryetari konstatoi se *ishin plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes dhe propozoi këtë*

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21. 07. 2009,
2. Njoftimi i Komisionit për vizitën e bërë nënave greviste lidhur me mbetjet mortore,
3. Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21. 07. 2009

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

2. Njoftimi i Komisionit për vizitën e bërë nënave greviste lidhur me identifikimin e mbetjet mortore

Kryetari – I përshëndeti anëtarët e Komisionit dhe ata që e monitorojnë punën e tij. I njoftoi se më 8. 9. 2009 Komisioni, në përbërje: Ismet Beqiri – kryetar, Sanije Alijaj, Hajredin Hyseni dhe Radmilla Vujoviq, i vizitoi nënat greviste, u solidarizua me grevën e tyre, i mbështeti për identifikimin e 405 mbetjet mortore dhe për ecurinë e zbardhjes

së fatit të personave të tjerë të pagjetur. Shtoi se Komisioni do të përpiqet në mënyrë institucionale, për aq sa lejon Rregullorja e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, të japë kontribut për ndriçimin e fatit të tyre.

Komisionit i propozoi të kërkojë nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës që sa më parë të caktohet një seancë plenare vetëm me një pikë të rendit të ditës: *Gjendja e krijuar me grevën e nënave, kërkesa e tyre për identifikimin e 405 mbetjeve mortore dhe ecuria e gjertanishme lidhur me zbardhjen e fatit të personave të tjerë të pagjetur. Lidhur me këtë pikë u hap diskutimi.*

Ibrahim Makolli – Shprehu shqetësimin për gjendjen e krijuar që ka të bëjë me dy çështje:

E para identifikimi i mbetjeve mortore që gjenden në kontejner dhe e *dyta* çështja e personave të tjerë të pagjetur.

Kërkoj nga Komisioni të mbajë takim me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe me Zyrën e Qeverisë për Persona të Pagjetur, që të shihet se cili është shkaku që nuk sillen analizat nga Bosnja. Nëse ky proces kërkon kohë, atëherë të kërkojmë të dërgohen në ndonjë vend tjetër. U pajtua me kryetarin që çështja e ngritur të futet sa më parë në rend dite të seancës plenare.

Luljeta Shehu – E njoftoi Komisionin për letrën e nënave greviste të 10. 9. 2009, me të cilën paralajmërojnë grevë urie nga 14. 9. 2009 dhe propozoi të shqyrtohet kjo çështje.

Drita Maliqi – Shprehu shqetësimin për gjendjen e krijuar. Theksoi se nuk është dashur të krijohej kjo gjendje. U pajtua me parafolësit lidhur me mbajtjen e seancës së veçantë plenare. Në fund kërkoj të shikohet mundësia për ndarjen mjeteve financiare për identifikimin e mbetjeve mortore.

Sanije Alijaj - I propozoi Komisionit që kjo çështje të futet në rend dite të seancës plenare dhe të diskutohet për të. Tha se kërkesa duhet t'i ketë për bazë Rezolutën e 10. 4. 2003 dhe letrën e nënave.

Të gjithë anëtarët e Komisionit ishin të mendimit që për këtë pikë të nxirret ky

P e r f u n d i m

Të caktohet një seancë urgjente plenare vetëm me një pikë të rendit të ditës:

Situata e krijuar lidhur me grevën e nënave, kërkesa e tyre për identifikimin e 405 mbetjeve mortore dhe ecuria e gjertanishme për zbardhjen e fatit të tyre.

3. Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë nuk pati debat.

Mbledhja përfundoi në orën 15: 00

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri
